

UDHËZIM
Nr. 15, datë 22.7.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 18.2.2009 TË MINISTRIT TË ARSIMIT
DHE SHKENCËS “PËR PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E DIPLOMËS SË LËSHUAR NGA
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 31 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 5, datë 18.2.2009, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 2 të shtohet:

“ç) “*Doktoratë*” në ... (*fusha e studimit të kryer*)”;

2. Germa “m” e pikës 4, të ndryshojë si më poshtë:

“m. Formën e studimeve, për ciklin e parë e të dytë të studimeve, si dhe, kur është përcaktuar në aktin e hapjes, për programin e doktoratës”;

3. Pas pikës 4.2 të shtohet pika 4.3, si më poshtë:

“4.3 *Diploma për gradën shkencore “Doktor” për secilin doktorant, të përmbajë edhe numrin e diplomës së studimeve universitare, të përfunduar më parë, përkatësisht të studimeve të integruara të nivelit të dytë (DIND), “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura”;*

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave Arsimore dhe Planifikimit Strategjik, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla